



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:250068

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05511873

P.nr.1442/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm Penal- gjyqtari Lulzim Hoxha, me bashkëpunëtoren profesionale Afërdita Kicaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit: R. (M.) B., nga fshati Gornjo Lubinje K.Prizrenit, për shkak të veprës penale: asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, nr. 06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2276-219 të datës 30.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren Naim Gashi, të akuzuarit R. B., me mbajtësin av. E.G., me datë 25.03.2024, publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 27.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R. B., nga i ati M., e ëma, e lindur, i lindur me datënnë fshatin Gornjo Lubinje K. Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i pesë fëmijëve, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, sboshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të numrit personal:

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 08.10.2019, në fshatin Lubunje, Komuna e Prizrenit, asgjëson, dëmton apo e bënë të papërdorshme pasurinë e personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të raporteve jo të mira në mes tyre dhe, mosmarrëveshjeve apo kontesteve pronësore, me qëllim e dëmton kulmin e stallës së të dëmtuarit B.U., me ç' rast të dëmtuarit i shkakton dëm material.

Me këto veprime, ka kryer veprën penale: asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, nr. 06/L-074.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 50, 52, 69, 70, 72, të KPK-së, dhe nenit 364 të KPPK-së:

Të akuzuarit R. BajR. i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

- Në shumën prej treqind (300,00) €, për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, të cilin dënim me gjobë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në mënyrën e lartcekur, atëherë mundësia e pagesës së dënimit me gjobë do të revokohet.
- Nëse i akuzuari R. B., nuk mund apo nuk dëshirojnë ta paguajë dënimin me gjobë në shumën e lartcekur, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € llogaritet 1 (një) ditë burgim, gjithsej 15 ditë burgim.
- I dëmtuari me adresë si në shkresat e lëndës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil-juridik.
- **OBLIGOHET** i akuzuari R. B., që ti kompensoj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej (20) njëzet euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej (20) njëzet euro, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Penal, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr. 2276-219 të datës 30.10.2019, kundër të akuzuarit: R. B., nga fshati Gornjo Lubinje K.Prizrenit, për shkak të veprës penale: asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, nr. 06/L-074.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor më datë 25.03.2024, në të cilin i akuzuarii pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit, pasi që i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, e ka pranuar fajësinë që i ngarkohet me aktakuzë

Në shqyrtimin gjyqësor, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, konform dispozitave ligjore të nenit 322 të KPPRK-së, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave dhe në kuptim të nenit 322. par. 4. të KPPRK-së ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroj se: qëndroj pranë aktakuzës, me këtë çështje penale pas pranimin të fajësisë; nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në aktakuzë dhe propozoj gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Gjykatës me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit propozoj që të ketë

parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata do të merr parasysh dashjen e të akuzuarit e kryerjes së veprës penale rrezikshmërinë konkrete e veprës penale si dhe dëmin e shkaktuar tek viktimat.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. B., av. E.G., në fjalën përfundimtare deklaroi se: pasi që i mbrojturi im ka deklaruar rrethe pranimin të fajësisë, dhe këtë e ka bërë pas konsultimit me mua si mbrojtës i tij, normalisht duke ditur pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë e po ashtu duke patur parasysh edhe natyrën e veprës penale kërkoj që së pari të pranohet pranimi i fajësisë, dhe po ashtu që gjatë caktimit të llojit të dënimit merret parasysh së pari pranimi i fajësisë bërë vullnetarisht, pendimi për veprën e bërë, premtimi që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën të tillë apo të ngjashme, e po ashtu gatishmërinë e tij që ti përgjigjet palës së dëmtuar.

I akuzuari R. B., në fjalën përfundimtare deklaroi se: pajtohet në tërësi me theksimet e të mbrojturit tim, tjetër nuk kam çfarë të shtojë, dhe shpreh keqardhje për veprimet e bëra.

Gjykata në shqyrtim gjyqësor nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datën 08.10.2019, në fshatin Lubunje, Komuna e Prizrenit, asgjëson, dëmton apo e bënë të përdorshme pasurinë e personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të raporteve jo të mira në mes tyre dhe, mosmarrëveshjeve apo kontesteve pronësore, me qëllim e dëmton kulmin e stallës së të dëmtuarit B.U., me ç' rast të dëmtuarit i shkaktonte dëm material.

Me këto veprime, ka kryer veprën penale: asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, nr. 06/L-074.

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë prej të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, andaj gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekzistonte ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 251 të KPPK-së.

Gjithashtu, në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPK-së, dhe se në veprimet e të akuzuarit, formohen të gjitha elementet e veprës penale të cekura më lartë, për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69, 70, 71, 72 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka shpreh keqardhje për rastin e ndodhur dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë veprime kundërligjore. Andaj, duke mos gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e

shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, ashtu që në të ardhmen të akuzuarin do ta parandalojë nga kryerja e veprave penale dhe se ky lloj i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari, dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla të kundërligjshme.

Gjykata vendimin e ka mbështetur duke u bazuar edhe në neni 38 i KPK-së i cili konsiston në *“parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimin për respektimin e ligjit”*.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).
- Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 462 par. 1. dhe 2. të KPPK-së.
- Vendimi mbi kompensimin e viktimave të Krimit, gjykata e mori në kuptim të nenit 36 parag.3 pika 3.1 të Ligjit me numër 08/L-109. ku thuhet *“për veprën penale që gjykohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore shuma është prej njëzet (20) Euro”*.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 1442/19, të datës 27.03.2024

B. Profesionale,
Afërdita Kicaj

Gjyqtari,
Lulzim Hoxha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga dita e pranimit të të njëjtit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.